



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_271\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_411\_05\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_411\_05\_10** ;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 21.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Hamdi Latifi (shifra e konsumatorit DPR – 73478) nga Besiana, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 11.01.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.12.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 26.08.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 17725630 dhe ka vendosur për matje njehsorin nr. 5424341.

**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000502 i datës 26.08.2009

- Me datë 25.09.2009 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17725630, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori kapakun e epërm nga ana e djathtë e ka të shpuar, ku përmes vrimës është penguar puna e diskut si dhe në brendi të njehsorit tabela e të dhënave teknike dhe disku i njehsorit janë të gërvishtura.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 20/25 i datës 25.09.2009
- Me datë 02.10.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtimin e njehsorit kanë bërë shqyrtimin mbi saktësinë e matjes së njehsorit elektrik me nr. 17725630 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes.  
**Provë:** Protokoll i mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 02/9297 i datës 02.10.2009
- Me datë 03.11.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe regjistrimin e pajisjeve që posedon konsumatori.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 389330 i datës 03.11.2009
- Me datë 18.11.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07961 në vlerë prej 149.64 €.  
**Provë:** Fatura DPR09HP07961 e datës 18.11.2009
- Me datë 30.11.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 22.12.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 22.12.2009
- Me datë 11.01.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_411\_05\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** KEK-un për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar